



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Shëndet për të Gjithë

përmes fuqizimit të rolit të gruas



Të gjesh rrugën tënde pavarësisht fillimeve të vështira!

"Hë se femër është, nuk i di mirë këto gjëra!" Kjo ishte fjalia që shqetësonte gjithnjë Dr. Irma Gishti, një mjeke e re familjeje në Roskovec.

Dr. Irma u emërua drejtoreshë e qendrës shëndetësore në vitin 2014 dhe rrëfen se fillimi ishte i vështirë. Ajo tregon *'Jo sepse nuk kisha eksperiencë në drejtim, as sepse duhet të isha edhe mjeke, edhe drejtoreshë. Ajo që më pengonte më shumë, kishte të bënte me faktin që shoqëria shqiptare, duke qenë një shoqëri maskiliste, e shikon me skepticizëm një grua drejtuese.'*

Por, a do ta ndërpriste dr. Irma rrugëtimin si drejtuese dhe ta pranonte 'fatin' e saj si grua?!

Qindra kilometra nga Roskoveci hasim të njëjtin realitet. Takojmë në Dibër Rovenën, e cila është pjesë e njësisë anti-korrupsion në Drejtorinë e Shëndetit Publik. *"Në qarkun Dibër ku jetoj, të jesh një grua profesioniste ose në karrierë është sfiduese nisur edhe nga mentaliteti që grua duhet të kujdeset vetëm për punët e shtëpisë dhe të merret me rritjen e fëmijëve ndërsa të ardhurat duhet t'i sigurojë burri i shtëpisë. Edhe unë personalisht, përveç mendimeve të tilla, jam përballur me disa sfida si për shembull: je grua dhe duhet t'u bindesh burrave. Mos kërkto të drejta, por ji mirënjohëse që ke një vend pune."*

Dr. Irma që përmendëm në fillim, punoi fort, kërkoi

mbështetje dhe zbuloi me edukimin dhe trajnimin e duhur do t. *"Pas fillimit të bashkëpunimit me HAP-in, m'u dha mundësia të marr pjesë në trajnime për menaxhimin shëndetësor, dhe jo vetëm, - tregon dr. Irma. - Falë këtyre trajnimeve mësova se çfarë kërkohet nga një drejtues dhe se çfarë duhet të bëja për t'u treguar njerëzve që ne, gratë, jemi serioze në punën tonë dhe që skepticizmi i tyre është i pabazë. Kuptova pikat e mia të forta dhe të dobëta dhe aspektet që duhet të përmirësoja. Cili ishte rezultati? Në takimin e dytë me komunitetin dhe pushtetin vendor, ndjeva që kishte ndryshuar perceptimi i punës sime si punë e drejtuar nga një grua."* Disa muaj më parë, dr. Irma u vlerësua si 'Mjeku i muajit' nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Edhe Rovenë tregon se tani ndihet më e fortë: *Tashmë jam e zonja të shpreh cdo pakënaqësi dhe madje të ngre zërin kur kam të drejtë. Të qenit grua nuk më pengon më."*

Dr. Irma dhe Rovenë janë ndër gratë e shumta që kanë qenë pjesë e trajnimeve, seminareve dhe shkëmbimit të eksperiencave të organizuara nga Projekti Shëndet për të Gjithë (Health for All Project-HAP) në qarqet e Fierit dhe Dibërës. Sikurse shumë prej profesionisteve të tjera gra që kanë marrë pjesë në aktivitetet e HAP-it, ato ndihen të inkurajuar që të ndryshojnë mënyrën e të punuarit duke ndryshuar, në radhë të parë, mënyrën e të menduarit.



Stafi mjekësor i qendrave shëndetësore në qarqet e Fierit dhe Dibrës marrin mbështetje të vazhdueshme nga projekti HAP për përmirësimin e aftësive të tyre në ofrimin e një shërbimi cilësor.

Gra të fuqizuara, shërbim më i mirë për komunitetin

“Kur u emërova fillimisht si mjeke familjeje, thuajse asnjë pacient nuk vinte në qendrën shëndetësore. Vinin vetëm 20 apo 30 persona një herë në dy muaj që merrnin recetën me rimbursim dhe kaq ishte puna ime, - kujton dr. Tushe Qalliu, drejtoreshë e qendrës shëndetësore në Aranitas (qarku Fier). - Por unë doja të bëja më shumë. Pasi u emërova si drejtoreshë e qendrës shëndetësore, kërkova dhe mora pjesë në trajnimet e organizuara nga HAP-i. Në sistemin shëndetësor ka shumë profesioniste gra, por në mentalitetin tonë, të jesh burrë i bën gjërat të duken ndryshe. Falë bashkëpunimit me projektin HAP, u njoha me njerëz që më buzëqeshnin dhe patjetër që edhe vetë zgjodha të buzëqesh, të respektoj e të dua njerëzit me të cilët punoj. Në këtë mënyrë, ne si staf i Qendrës Shëndetësore jemi rritur nga dita në ditë. Përballemi me probleme të ndryshme, por nuk i fshehim ato, përkundrazi, diskutojmë për të gjetur zgjidhjen e duhur ndërsa i ofrojmë komunitetit një shërbim më të mirë shëndetësor. Këtu do të veçoja fazën eksperimentale të fushatës ‘PërSHËNDETje’ ku i gjithë stafi i qendrës shëndetësore u trajnuar dhe 304 banorë u informuan për jetesën e shëndetshme”.

Dr. Albjona Lamaj, drejtoreshë e qendrës shëndetësore në Patos, është një tjetër profesioniste grua e cila tregon eksperiencën e saj. ‘Dua të falënderoj projektin HAP për bashkëpunimin dhe për çfarë jam unë sot dhe se sa e aftë ndihem në marrjen e përgjegjësisë, mbrojtjen e pozicionit tim dhe ofrimin e një shërbimi më të mirë për banorët. Kur

u emërova drejtoreshë, eksperiencia ime në menaxhim e drejtim ishte pothuajse zero. Ajo që na bëri të mundur projekti, ishte hapja e një dritareje të re për të parë se çfarë duhet të ndryshonim për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe të kuptonim që, edhe gjëra të vogla që nuk kërkojnë shpenzim apo infrastrukturë moderne, mund të sjellin rritje të cilësisë. HAP-i më mësoi që duhet të isha lidere në drejtim, dhe jo shefe. Gjithashtu, mësova zbatimin e përqasjes me pjesëmarrje në sajë të së cilës edhe anëtarët burra të ekipit arritën të bëheshin pjesë e ndryshimeve të cilat i diskutoja, ndaja dhe vendosja së bashku me ta.”

Përvoja e dr. Albjonës nuk mbaron me kaq. Aftësitë e fituara falë trajnimeve të HAP-it, ajo i ka pasqyruar edhe në Këshillin Bashkiak ku është anëtare: “HAP-i më ka ndihmuar të zhvilloj aftësitë e mia të komunikimit dhe të paraqitjes së problemeve bazuar në fakte, duke përballuar sfidën time të marrjes së fjalës, diskutimit dhe ndikimit të Këshillit Bashkiak ku 70% e anëtarëve janë burra. Tani mund të them me bindje të plotë se kjo më ka shërbyer për të krijuar një formë bashkëpunimi jashtëzakonisht të fortë midis qendrës shëndetësore dhe Bashkisë Patos.”

Albjona ndihet më e sigurt: “Trajnimet/bashkëpunimi me HAP-in më kanë zhvilluar personalisht mua si grua profesioniste, por kanë ndikuar gjithashtu në zhvillimin dhe emancipimin profesional të mjekëve dhe sidomos të infermierëve, duke ndikuar në rritjen e rolit dhe autoritetit të tyre përballë komunitetit duke ofruar shëndet më të mirë



për të gjithë.”

Kryetarja e Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi, vëren gjithashtu se edukimi i mundësuar përmes HAP-it ka ndikuar pozitivisht tek komuniteti: “Një grua nuk mund të jetë kurrësi e suksesshme në drejtim pa mbështetje dhe pa përgatitje të mirëfilltë profesionale. Gjatë bashkëpunimit me HAP-in kam vënë re se mbështetja që iu jepet grave është jo vetëm në aspektin profesional, por edhe në atë moral. Tashmë do të ketë kushte më të mira pune për mjekët dhe infermierët të cilët punojnë në këto qendra shëndetësore¹.”

“HAP-i na ka bërë të mundur që të pasqyrojmë rolin e gruas dhe personalisht jam ndjerë më shumë profesioniste si infermiere, - thotë Entela Kaloshi, e cila punon në qendrën shëndetësore Kastriot (Qarku Dibër). - Gjithashtu, edhe

koleget e mia infermiere, pjesëmarrëse në trajnime, kanë fituar më shumë besim te vetja në rolin e tyre në shoqëri dhe kanë përcjellë tek komuniteti njohuritë që fituan gjatë takimeve.”

Kryetarja e Bashkisë Patos (qarku Fier), Rajmonda Balilaj, mendon se gratë drejtuese në një qytet të vogël si Patosi mund të bëjnë shumë për gratë dhe vajzat e tjera. “Si një Kryebashkiake grua, çështja e barazisë gjinore është në fokus të politikave që kemi ndërmarrë së bashku me stafin, - thotë Rajmonda. - Evidentimi dhe promovimi i potencialeve të mundshme, projektet me karakter social që kanë në fokus gruan, investime të dedikuara për gratë janë disa nga nismat që janë bërë me zemër dhe ku po punohet me përkushtim e dashuri.”

Nëse nuk ndriçon nga brenda, nuk mund të shkëlqesh nga jashtë

Gratë profesioniste që kanë marrë pjesë në aktivitetet e HAP-it, e filluan ndryshimin së brendshmi (brenda vetes së tyre dhe brenda qendrës shëndetësore ku ato punojnë).

Ardiana Kola, kryeinfermiere në QSH Roskovec thotë se trajnimet dhe seminarët e organizuara nga HAP-i e kanë ndihmuar që të kuptojë më mirë punën dhe të përmirësojë njohuritë e saj për organizimin e shërbimit shëndetësor. “Trajnimi i mundësuar nga HAP-i mbi komunikimin, punën në grup, lidhshimin dhe zgjidhjen e problemeve, më bëri më të vetëdijshme mbi rolin tim në shoqëri, - thotë Ardiana. - Komunikimi mes kolegëve u bë më i thjeshtë dhe më profesional, gjë që çoi në një bashkëpunim më të mirë në mbarëvajtjen e punës në qendrën shëndetësore. Zgjidhja e problemeve është më efektive. Rritja e besimit në vetvete më bëri të jem më e hapur në shprehjen e mendimeve të mia. Gjithashtu, jam më e sigurt në dhënien e informacionit ndaj pacientëve në një mënyrë më të kuptueshme për ta, gjë e cila më ka afruar më shumë me komunitetin.”

Dr. Malvina Manga, drejtoreshë e QSH Melan (qarku Dibër) shprehet se është rritur profesionalisht: Kam përmirësuar aftësitë e lidhshimit, marrëdhëniet me komunitetin dhe integritetin e gruas në shoqëri. Eksperiencën e suksesshme me Grupin e Kolegëve në rolin tim si facilitatore, përveçse ka përmirësuar cilësitë e mia të lidhshimit, ka përçuar edhe një model të gruas së re, mjekes së re, me rëndësi në drejtim dhe transmetim të informacionit në një komunitet profesional. Si rezultat, më ka ndihmuar të fitoj vetëbesim në dijet mjekësore dhe në marrëdhëniet me kolegët.”

Të njëjtin efekt vëren edhe Behare Kola, infermiere në QSH Koms (qarku Dibër). Ajo është e lumtur me njohuritë që ka marrë dhe mendon se këto dije kanë sjellë progres. “Mendoj se duke ditur të drejtat dhe detyrat, fuqizohet roli i grave në shoqëri, sepse kur nuk di të drejtat e tua, nuk di as se si të mbrohesha, - thotë ajo. - Pa dyshim që HAP-i ka sjellë progres në këtë drejtim. Falë

bashkëpunimit me HAP-in, ne dimë t'i trasmetojmë këto njohuri tek kolegët dhe tek komuniteti ku shërbejmë. Ky projekt na ka dhënë guxim, besim dhe modelin më të mirë për të qenë të suksesshëm në profesionin tonë.”

Edhe Mbaresë Dima, infermiere në qendrën shëndetësore Portëz, ndihet më e forcuar. Ajo tregon: “Gjithmonë më ka pëlqyer që, përveç punës së përditshme dhe impenjimeve familjare, të aktivizohesha edhe me diçka tjetër dhe m'u besua roli si facilitatore e HAP-it për aktivitetet në qendrën shëndetësore ku punoj. Trajnimet që kam zhvilluar me HAP-in, më kanë bërë të ndihem më lart profesionalisht, duke më dhënë guxim dhe besim në vetvete për t'u përballur me situata të ndryshme gjatë punës së përditshme dhe për t'i menaxhuar ato me profesionalizëm, etikë dhe korrektësi”.

‘Doja të sfidoja veten!’ Kjo ishte arsyeja që nxiti Xhulieta Likën, infermiere në qendrën shëndetësore nr.2 në Lushnjë, të merrte pjesë në trajnimet e HAP-it. “Me kalimin e viteve punonjësit në shërbimet publike ‘ndryshken’, - rrëfen ajo. - Gjatë këtyre viteve unë mësova të kem besim tek vetja dhe koleget e mia, të përmirësoj mënyrën e komunikimit midis kolegëve dhe pacientëve, të jem elokuede, të jem e sigurtë dhe, nëse e kam gabim, të dëgjoj me kujdes pavarësisht diferencave në moshë”. Tani ajo është e bindur se në sajë të këtyre ndryshimeve është një profesioniste më e mirë në ofrimin e shërbimit shëndetësor.

Eljona Troka, infermiere në qendrën shëndetësore Frakull (qarku Fier), ndan të njëjtin mendim: “Mësova se gratë mund të drejtojnë në mënyrë të suksesshme. Drejtova një grup kolegësh të përbërë nga 7 gra dhe 5 burra dhe mendoj se kam bërë një punë të mirë. Projekti HAP na tregoi eksperiencën se si gratë mund të jenë drejtuese të suksesshme. Nga këto trajnime tek ne është pasqyruar modeli i gruas së suksesshme dhe këtë gjë e kam transmetuar tek koleget e mia gjatë rolit tim si facilitatore e Grupit të Kolegëve.”

¹ Qendrat shëndetësore në Roskovec dhe Strum (Bashkia Roskovec) janë rehabilituar në vitin 2018 nga HAP-i.



Xhulieta Lika është një prej facilitatoreve të Grupeve të Kolegëve-një mjet i Edumikimit të Vazhdueshëm Mjekësor i paraqitur dhe mbështetur në vijimësi nga projekti HAP.



Rreth 47% e pjesëmarrësve në fazën eksperimentale të fushatës 'PërSHENDETje' ishin meshkuj dhe 53% femra.

Qasja e barazisë gjinore si një çështje transversale e Projektit Shëndet për të Gjithë

Projekti Shëndet për të Gjithë (HAP), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) dhe zbatuar nga konsorciumi i udhëhequr nga Instituti Zviceran i Mjekësisë Tropikale dhe Shëndetit Publik (Swiss TPH), Terre des hommes dhe Save the Children, filloi zbatimin në vitin 2015. Projekti synon të ndihmojë popullatën e qarqeve Fier dhe Dibër për të përfutur shëndet më të mirë nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor dhe aktiviteteve të promovimit të shëndetit. Me këtë synim, Projekti Shëndet për të Gjithë ka investuar në: forcimin e Menaxhimit të Kujdesit Shëndetësor, përmirësimin e infrastrukturës, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM).

Barazia gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas është një prej çështjeve ndërsektoriale të cilave HAP-i dëshiron t'i kushtojë vëmendje dhe konsiderohet si pjesë integrale e aktiviteteve të Projektit në përputhje me synimet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Në sajë të përmasave, intensitetit dhe shtrirjes së aktiviteteve të tij, HAP-i ka prekur të gjithë profesionistët e shërbimit shëndetësor primar (240 mjekë familjeje dhe 1100 infermiere) dhe komunitetin në të dy qarqet. Në të gjithë portofolin zviceran² projekti rreket të promovojë një politikëbërje të ndjeshme ndaj çështjes gjinore, rritje

të përfaqësimit të grave në proceset vendimmarrëse, uljen e barrës së punës së papaguar për gratë dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në arsim dhe në tregun zyrtar të punës.


Në qarqet e Dibrës dhe Fierit ku HAP operon, rreth 80% e stafit mjekësor përbëhet nga gratë dhe 50% e drejtuesve të qendrave shëndetësore të kujdesit parësor janë gra. Duke konsideruar këto shifra, HAP-i ka ndërrhyrë përmes aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor, të cilat ndihmojnë profesionistët gra të kujdesit shëndetësor që të forcojnë kapacitetet dhe aftësitë e tyre, të rrisin vetëbesimin dhe vetëvlerësimin në mënyrë që të ndihen më profesioniste dhe të vlerësuara, siç u tregua në këto intervista. Sikurse theksohet në ICPD³, "Edukimi është një prej mjeteve më të rëndësishme për fuqizimin e rolit të gruas me njohuritë, aftësitë dhe vetëbesimin e nevojshëm për të marrë pjesë plotësisht në procesin e zhvillimit".

Grupet e Kolegëve (GK) janë një mjet i edukimit të vazhdueshëm mjekësor të cilat formohen dhe operojnë në nivelin e qendrave shëndetësore midis mjekëve të familjes dhe/ose infermierëve. Grupet e Kolegëve kanë shërbyer si një derë hyrëse në dinamikën e secilës qendër shëndetësore dhe shërbimin që ato ofrojnë.

² Strategjia e Bashkëpunimi Zviceran Shqipëri, fq. 16

³ <http://www.un.org/popin/icpd/conference/offeng/poa.html>

ACTIVITIES CARRIED OUT BY HAP



* Masteri Profesional në Menaxhim Shëndetësor ofrohet si një bashkëpunim i Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Ekonomisë.

Duke iu referuar Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim⁴ (SDC), puna me barazinë gjinore si një çështje transversale, është një prej strategjive për integrimin e barazisë gjinore. Në nivel projekti apo sektori kjo kërkon që para çdo vendimi të kryhet një analizë mbi ndikimin që ka vendimi në fjalë tek gratë dhe burrat. Gjithashtu, kërkon pjesëmarrjen e burrave dhe grave përgjatë të gjithë ciklit të planifikimit dhe përfshirjes sistematike të nevojave dhe përparësive të tyre.

HAP⁵ monitoron sistematikisht pjesëmarrjen e burrave dhe grave në aktivitetet e projektit dhe forcimi i kapaciteteve të grave promovohet sistematikisht në mënyrë që të mbushen boshllëqet ekzistuese përsa i përket barazisë gjinore në Shqipëri. Në këtë grafik janë përmbledhur pjesëmarrja e burrave dhe grave në aktivitetet e ndryshme të zbatuara nga HAP-i. Është e dukshme që në aktivitetet e mbështetura nga HAP-i ka një pjesëmarrje më të madhe të grave dhe duhet punuar më shumë në rritjen e rolit të tyre si drejtuese dhe vendimmarrëse.

Barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë njerëzore, por është një kusht për zhvillimin dhe reduktimin e varfërisë. Gratë e fuqizuara kontribuojnë në shëndetin dhe produktivitetin e familjeve, komuniteteve dhe përmirësojnë të ardhmen e brezave që do të vijnë.

Barazia gjinore dhe burimet njerëzore në sektorin shëndetësor në Shqipëri janë një fushë që kërkon studim dhe analizim të mëtejshëm. Agjencia Zvicerane për Zhvillim

dhe Bashkëpunim (SDC) ka kontribuar, përmes Projektit Shëndet për të Gjithë, në mbushjen e hendeqeve të barazisë gjinore dhe ndryshimin e realiteteve. HAP-i do të vijojë të zgjerojë ndërhyrjet e tij në sektorin shëndetësor duke u fokusuar tek kapërcimi i hendekut të barazisë gjinore jo vetëm në lidhje me burimet njerëzore, por edhe përsa i përket shërbimit të ofruar duke synuar ofrimin e një shërbimi më të mirë në përputhje me nevojat gjinore të popullatës shqiptare.



² SDC Gender in practice toolkit

³ Raporti I Progresit I HAP për periudhën janar-qershor 2018

Falenderojmë bashkëpunëtorët tona, mendimet e të cilave janë publikuar në këtë broshurë.

(Duke filluar nga sipër, majtas: Eljona Troka; Irma Gishti; Majlinda Bufi, Malvina Manga, Mbarea Dimo, Rajmonda Balili, Rovena Islami, Tushe Qalliu, Albjona Lamaj, Behare Kola)/



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Health for All Project

📍 Rruga Themistokli Gërmenji
Pallati 10, Kati II, Apt. 1
Tirana, Albania

✉ info@hap.org.al

We are in Social:

-  Health for All Project-HAP
-  Health for All Project (HAP)
-  health.for.all.project
-  hap_project

www.hap.org.al